



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 190/1 prot.

Tiranë më 2.2.2019

Lënda: Përgjigje kërkesës për mendim

AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u njoh me kërkesën tuaj, administruar me nr. 190 prot, datë 04.02.2019, dhe me rrethanat e parashtruara nga ana juaj. Paraprakisht, vlerësojmë angazhimin tuaj në respekt të detyrimeve ligjore dhe në këtë kuadër, ju bëjmë me dije lidhur me disa detyrime që keni në cilësinë e kontrolluesit, në kuadër të respektimit të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, duhet kryer duke pasur parasysh respektimin e nenit 5/b, të Ligjit nr. 9887 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, mbrojtja e të dhënave personale, bazohet: *b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime:...*

Aksesi në të dhënat personale konsiderohet përpunim dhe përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Të dhënat personale përpunohen vetëm: *ç) për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit:...*

Në rastin tuaj, përpunimi duhet të gjejë mbështetje në një parashikim ligjor konkret me qëllim që përhapja të konsiderohet e ligjshme.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi